

VENDIM
Nr.5, datë 11.3.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i	“ “
Gjergj Sauli	Anëtar i	“ “
Kristofor Peçi	Anëtar i	“ “
Kujtim Puto	Anëtar i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar i	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i	“ “
Alfred Karamuço	Anëtar i	“ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 9.3.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.8 Akti që i përket:

KËRKUES: GJIN GJONI, përfaqësuar nga avokat Fatmir Gjika.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. **KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË**, përfaqësuar nga zëvendëskryetari, zoti Ilir Panda, me autorizim.

2. **KONFERENCA KOMBËTARE GJYQËSORE**, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.151/1, datë 31.1.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kërkuesi ka parashtruar se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor në këto drejtime:

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka të drejtë të heqë mandatin e dhënë nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare;
- Në votim, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë janë përjashtuar katër anëtarët e rinj;
- Nuk është dëgjuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë kur është marrë vendimi;
- Janë përdorur dy standarde nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë lidhur me stazhin e ndihmësgjyqtarit të emëruar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, kërkuesin e përfaqësuesin e tij, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë në datën 31.1.2004, në zbatim të neneve 9 e 10 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ka proceduar në verifikimin e mandateve të 5 (pesë) anëtarëve të rinj të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Në përfundim, me vendimin nr.151/1, datë 31.1.2004, Këshilli i Lartë i Drejtësisë konstaton se katër anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë zgjedhur në përputhje me ligjin, ndërsa përta të përkërkuesit, është konstatuar dhe çmuar se zgjedhja e tij është bërë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi i parë i ligjit të lartpërmendur, për arsye se ai ka ushtruar detyrën e gjyqtarit për më pak se 10 (dhjetë) vjet. Ndërkohë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka kërkuar Konferencës Gjyqësore Kombëtare zhvillimin e zgjedhjeve të reja.

Në shqyrtimin e kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese i referohet para së gjithash përmbajtjes e kuptimit të dispozitave kushtetuese, e veçanërisht nenit 147 të Kushtetutës, si dhe dispozitave të ligjit

nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Duke shqyrtuar raportet kushtetuese e ligjore midis Konferencës Gjyqësore Kombëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka në rastin e dhënë, në kuptim të nenit 10 të ligjit, vetëm të drejtën e pezullimit të ushtrimit të mandatit dhe të kërimit të zgjedhjeve të reja.

Në këto kushte, kur vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk është përfundimtar, lidhur me të drejtën e kërkesit për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese e gjen kërkesën e paraqitur jashtë juridiksionit të saj të përcaktuar nga dispozitat kushtetuese. Edhe pse kërkesa është drejtuar për një proces të parregullt ligjor, përderisa ajo është e lidhur pazgjidhshmërisht me aktin objekt konflikti kushtetues, është e domosdoshme që ai të jetë përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe në neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.